



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:090455

Datë: 02.02.2024

Numri i dokumentit: 05279924

Ac.nr.7513/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj, kryetar i kolegjit, Naim Mehulli dhe Frosina Sylejmani, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike të paditëses Sh. (Z.) S., e vajzërisë B. nga Prizreni, rr. “S”, nr... të cilën me autorizim e përfaqëson av. S.R. nga Prizreni kundër të paditurës Komuna e Prizrenit të cilën e përfaqëson av. B.M., për vërtetimin e pronësisë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2565/2021, të datës 08.09.2022, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 29.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET e themeltë ankesa e të paditurës Komuna e Prizrenit, PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2565/2021, të datës 08.09.2022.

II. HEDHET poshtë si e palejuar padia e paditëses Sh. (Z.) S., e vajzërisë B. nga Prizreni, rr. “Saraqeve”, nr..., kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, për shkak të vërtetimit të pronësisë.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.2565/2021, të datës 08.09.2022, ka vendosur: I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Sh. (Z.) S., e vajzërisë B. nga Prizreni, ashtu që VËRTETOHET se paditësja në bazë të trashëgimit dhe në bazë të Listës Poseduese ka qenë pronare dhe mbajtëse e ngastrave kadastrale nr.7027/2, në vendin e quajtur “V.”, në sipërfaqe prej 43 m2 dhe ngastrës kadastrale 7027/4, në vendin e quajtur “V.” në sipërfaqe prej 760 m2 ZK Prizren. II. VËRTETOHET se e drejta e pronësisë nga par.1 i këtij

aktgjykimi ka pushuar më aprovimin e Planit Detal Urbanistik për lagjen “Ortakoll” me të cilin është vërtetuar interesi i përgjithshëm ku në bazë të cilit këto ngastra janë destinuar më qëllim të ndërtimit të lagjes “Ortakoll” si dhe në bazë të këtij aktgjykimi paditësja ka të drejt të kërkon kompensimin për ngastrat kadastrale të marra. III. Ky aktgjykim nuk e ka cilësinë e titullit ekzekutiv, por me të njëjtin vetëm vërtetohet ekzistimi i interesit juridik.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura: për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të Kosovës që ta aprovoj ankesën e të paditurës si të bazuar, ashtu që ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar duke e refuzuar në tërësi kërkesë padinë e paditëses si të pa bazuar, apo të njëjtin ta prish dhe çështjen t’ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Paditësja, ka parashtruar përgjigje në ankesë me propozim që të refuzohet në tërësi si e pa bazuar ankesa e e të paditurës dhe të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar.

Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, në kuptim të nenit 194 të LPK, ekzaminojë aktgjykimin e shkallës së parë brenda kufijve dhe shkaqeve të treguara në ankesa dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore dhe gjeti se:

-Ankesa e të paditurës është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi Sh. (Z.) S., e vajzërisë B. nga Prizreni, rr. S., nr.10, me datë 03.04.2017, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, për shkak të vërtetimit të pronësisë me kërkesë si në kërkesën e parashtruar me padi.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditëses, ka caktuar shqyrtimin kryesorë, pas dëgjimit të palëve ndërgjyqëse, administrimit të provave, ka marrë aktgjykimin C.nr. 411/2017 të datës 15.07.2019, duke e aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesë padinë e paditëses, më konkretisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura: për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të Kosovës që ta aprovoj ankesën e të paditurës si të bazuar, ashtu që ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar duke e refuzuar në tërësi kërkesë padinë e paditëses si të pa bazuar, apo të njëjtin ta prish dhe çështjen t’ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje

Gjykata e Apelit me aktvendimin Ac.ne. 5100/2019 të datës 07.10.2021, ka aprovuar ankesën e të paditurës dhe e ka prishë aktgjykimin e ankimuar C.nr. 411/2017 i datës 15.07.2019 dhe çështja është kthyer në rigjykim dhe ri vendosje.

Gjykata e shkallës së parë, në rivendosje, ka caktuar shqyrtimin kryesorë, pas dëgjimit të palëve ndërgjyqëse, administrimit të provave, ka marrë aktgjykimin e ankimuar C.nr. 2565/2021 të datës 08.09.2022, duke e aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesë padinë e paditëses, më konkretisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ndër të tjera ka theksuar se: Nga administrimi i të gjitha provave në shqyrtimin kryesor dhe mbi bazën e gjendjes faktike gjykata ka vendosur sikurse në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi se paditësja është pronare e ngastrave kadastrale 7027/2 dhe 7027/4 ZK Prizren i cili fakt vërtetohet nga certifikatat pronësore lidhur më këto ngastra dhe ekspertizat e ekspertit të gjeodezisë. Gjithashtu gjykata vendosi sikurse në dispozitivin nën II të këtij aktgjykimi duke konstatuar se e drejta e pronësisë lidhur më këto ngastra kadastrale ka pushuar faktikisht për shkak se këto ngastra janë të përfshira sipas Planit Detal Urbanistik për lagjen “Ortakoll-Lakuriqi Verior” i cili fakt vërtetohet nga administrimi i provave materiale posaçërisht nga ekspertizat e ekspertit të gjeodezisë i cili shprehimisht në ekspertizat e tij ka theksuar se ngastrat kadastrale 7027-2 dhe 7027-4 ZK Prizren gjenden në kuadër të planit detal urbanistik për lagjen “Ortakoll-Lakuriqi Verior” dhe se këto ngastra janë të përfshira në kuadër të rrugës publike “B. T.” të cilave prova gjykata ia fali plotësisht besimin. Gjithashtu se ekziston kjo gjendje faktike në teren, pra se këto ngastra janë në kuadër të rrugës publike “B. T.” dhe përdoren si rrugë këtë fakt gjykata e vërtetoi me shikimin e vendit të ngjarjes, andaj nga të gjitha këto të dhëna të cekura më lartë gjykata vendosi sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi duke u bazuar në 18 të Ligjit nr.03/L-154 mbi Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore dhe akteve tjera normative të paditurës sa i përket ekzistimit të planit detal urbanistik për lagjen “Ortakoll”.

Më tej ka arsyetuar se: Me rastin e vendosjes gjykata ka marr për bazë aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë Ac.nr.5100/2019 dt.07.10.2021, pra ka vepruar sipas udhëzimeve të tij dhe ka konstatuar se Sh. (Z.) S. e vajzërisë B. është personi i njëjtë me H. (Z.) B. i cili fakt vërtetohet nga certifikata 02 nr.036/896 dt.18.11.2013 lëshuar nga sektori i administratës së përgjithshme të Komunës së Prizrenit dhe nga ekstrakti i lindjes dhe certifikata e lindjes të lëshuara nga zyra e ofiqarisë në Prizren, kështu duke marr për bazë këtë fakt të vërtetuar si më lartë gjykata gjithashtu vlerëson se pala paditëse është e përfaqësuar ligjërisht nga av. S. R. për shkak se autorizimi i noterizum LRP.nr.6862/2018 dt.21.12.2018 që është përpiluar nga noterja Suna Sallahi autorizuese është Sh. (Z.) S., e vajzërisë B. në këtë rast paditësja, më të cilin autorizim e ka autorizuar që në këtë çështje ta përfaqëson Sh. (Hilmi) Ç. me të drejt që këtë autorizim ta bart në ndonjë person të tretë apo avokat, kështu që i autorizuari Sh. Ç. më dt.21.01.2019 e bart autorizimin në avokatin S. R..

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës, gjykata e shkallës së parë e ka bazuar në kuptim të nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës, nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës se vendosjes nuk është i drejtë dhe i ligjshëm. Përkundër faktit se aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe as me shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, sipas pretendimeve ankimore të palës

ankuese. Sipas kësaj gjykate gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, nuk korrespondon drejtë me provat nga shkresat lëndore. Për pasojë me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar, ka pasur zbatimin e gabuar të së drejtës materiale. Gjykata e Apelit duke shqyrtuar ankesën brenda kufijve të paraqitur nga ankuesi në ankesë e duke u kujdesur për zbatimin e së drejtës materiale sipas detyrës zyrtare ka konstatuar se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit paraprak të padisë është dashur ta hedhë poshtë si të pa lejuar padinë dhe jo të vendos për themelësinë e saj.

Nga shkresat e lëndës del se paditësja ka paraqitur padi për shkak të vërtetimit të pronësisë në ngastrën kadastrale nr. 7027/... në vendin e quajtur “V.”, në sipërfaqe prej 43 m2 dhe ngastrën kadastrale nr. 7027/.... në vendin e quajtur “V.”, në sipërfaqe prej 7.. m2 që të dyja në ZK. Prizren.

Gjykata e Apelit duke bërë shikimin në shkresat e lëndës, konstaton se në këtë çështje kontestimore, paditëses i mungon interesi juridik, pasi që e njëjta duke qenë pronare e paluajtshmërive kontestuese kërkon nga gjykata që të vërtetohet se e njëjta ka qenë dhe është pronare e sajë. Në këtë kuptim gjykata e shkallës së dytë vlerëson se me rastin e vendosjes gjykata e shkallës së parë nuk e ka zbatuar drejtë të drejtën materiale, përkatësisht dispozitat e nenit 391 të LPK-së, pasi që e njëjta fillimisht është dashur që të kujdeset në bazë të detyrës zyrtare për lejueshmërinë e padisë në kuptim të interesit juridik të kërkesë padisë, e që një gjë e tillë nuk është vlerësuar fare nga gjykata e shkallës së parë edhe për kundër se në shkresat e lëndës që nga parashtrimi i padisë e deri në përfundim të shqyrtimit kryesor kishte prova të mjaftueshme për të vlerësuar interesin juridik. Andaj, në këtë kuptim Gjykata e Apelit vlerëson se padia e paditëses është e pa lejuar në mungesë të interesit juridik dhe e njëjta duhet të hedhet poshtë si e pa lejuar. Sipas nenit 391, pika e) të Ligjit për Procedurën Kontestimore i cili parasheh që “*Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se:...* e) *për objektin e kontestit është lidhur ujdia gjyqësore, se paditësi në gjykatë ka hequr dorë nga kërkesëpadia, se nuk ekziston interesi juridik i paditësit për padi vërtetimi*”, ndërsa sipas nenit 2 par. 4 të LPK-së, i cili parasheh që “*Pala duhet të ketë interes juridik për padinë dhe për veprimet procedurale tjera që mund të kryhen në procedurë*”. Pra, në rastin konkret nuk ishte kontestuese se paditësja ka qenë dhe është pronare e ngastrave kadastrale kontestuese dhe kjo është vërtetuar edhe nga certifikata e pronësisë me nr. 07-029-Ç-4552-18 e datës 10.12.2018, nga e cila vërtetohet se paditësja është titullarë e paluajtshmërive me nr. 7027/2 dhe 7027/4 me 1/1, por që është vërtetuar edhe nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezie, i cili ka konstatuar të njëjtën gjendje. Andaj, në këtë konteste paditësja nuk mund të ushtroj padie për vërtetimin e pronësisë në këto paluajtshmëri ku në ndër kohë figuron që është pronare.

Gjykata e Apelit vlerëson se paditësja çfarëdo lloj kontesti tjetër në lidhje me këto parcela kontestuese, mund të inicioj pranë gjykatës kompetente për zgjidhjen e të njëjtit dhe realizimit të pretendimeve të saja, por jo në këtë procedurë për vërtetim të pronësisë, pasi që paditë për vërtetim paraqiten kur paditësi ka interes juridik që gjykata të vërtetojë ekzistimin apo mosekzistimin e ndonjë të drejte. Sipas nenit 254.2 të LPK-së, i cili parasheh që “*Padia e këitillë mund të ngrihet kur kjo është përcaktuar me dispozita të posaçme, apo kur paditësi ka interes juridik që gjykata të vërtetojë ekzistimin apo mosekzistimin e ndonjë të drejte apo të raportit*

juridik, ose vërtetësinë, respektivisht mos vërtetësinë e ndonjë dokumenti para se të jetë bërë e kërkueshme kërkesa për pretim nga raporti i njëjtë”. Andaj, në rastin konkret paditësja nuk kishte interes juridik për vërtetimin e pronësisë në parcelat kontestuese pasi që e njëjta një të drejtë të tillë tani më e ka pasi që edhe tani është pronare juridike e këtyre paluajtshmërie dhe ky fakte nuk ishte kontestues mes palëve dhe se e njëjta mund të parashtroj kërkesa tjera eventuale në lidhje me këto paluajtshmeri.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi duke vendosur që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale në kuptim të nenit 450 të LPK-së.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.7513/2022, datë 29.01.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Besnik Bislimaj,d.v